

Shpallje për kandidatë për ndjekjen e studimeve në Akademinë e Xhandarmërisë dhe Rojës Bregdetare Turke, gjithësej katër kuota dhe Akademinë e Policisë Turke, gjithësej 2 kuota, të cilët do të rekrutohen si punonjës të nivelit të mesëm, në strukturat e Gardës së Republikës.

KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE SIPAS KUOTAVE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT:

Për aplikantët, të cilët do të kandidojnë për 6 kuotat e programit të studimit 4-vjeçar (bachelor dhe specializim për oficer) dhe 1 vit gjuhë turke:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë mbaruar shkollën e mesme brenda ose jashtë vendit dhe diploma të jetë e njehsuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- c) Të mos jetë i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë nga organet e drejtësisë ose të mos jetë në ndjekje nga organet e drejtësisë; (vërtetim nga Prokuroria, Gjykata dhe dëshmi penaliteti ose dokumenti vërtetues i aplikimit për dëshminë e penalitetit)
- d) Të mos jetë më shumë se 21 vjeç në datën e aplikimit;
- e) Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- f) Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe të mos vuajë nga sëmundje kronike të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive;
- g) Të jetë mbi 175 cm;
- h) Mesatarja e notave të viteve të shkollës së mesme të jetë mbi 7;

Kandidati, i cili nuk plotëson të paktën një nga kriteret e mësipërme skualifikohet dhe nuk kalon në fazat e tjera të vlerësimit.

Në përfundim të këtij programi studimi aplikantët do të marrin titullimin “Oficer”.

Faza e aplikimeve përfundon më datë 25 gusht 2025.

Kandidatët për të dy programet e studimit duhet të paraqesin në Sektorin e Burimeve Njerëzore këto dokumenta:

- 1. Kërkesë për ndjekjen e studimeve, ku të përcaktohet programi për të cilin aplikon.
- 2. Fotokopje të kartës së identitetit
- 3. Fotokopje e noterizuar e diplomës (sipas nivelit të studimeve që aplikon)
- 4. Vërtetim nga gjykata,
- 5. Vërtetim nga Prokuroria
- 6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti), dokumenti i aplikimit për dëshminë e penalitetit, (Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore)
- 7. Raport mjekësor që vërteton se nuk është bartës i viruseve AIDS dhe Hepatit B, dhe që nuk vuan nga sëmundje kronike të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkrive.

Dokumentat do të dërgohen në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, Pallati i Brigadave, Tiranë, brenda datës 25.08.2025. (kontakti E-mail: institucioni@garda.gov.al).

Komisioni i Testimit, **në datën 26.08.2025, ora 08⁰⁰**, bën vlerësimin e kandidatëve në ambientet e Qendrës së Aftësimit Profesional në Mullet, përmes një procesi përzgjedhës, i cili do të zhvillohet në këto faza:

- a) Vlerësimi i formimit arsimor dhe kualifikimeve (deri në 20 pikë);
b) Testimi fizik (deri në 40 pikë);
d) Intervista e strukturuar me gojë (deri në 40 pikë);

Tabela e normave të testimit fizik të kandidatëve

Nr	ELEMENTËT TESTUES	PËR SASINË/ KOHEN		PIKËT
		Meshkuj	Femra	
1	Ulje – ngritje me forcën e krahëve (pompa) për kohën 2’.	60	30	25
		57	27	23
		55	25	20
		52	22	17
		50	20	15
		47	17	13
		nën.47	nën.17	0
2	Palosje – shpalosje me muskujt e barkut për kohën 2’.	60	30	25
		57	27	23
		55	25	20
		52	22	17
		50	20	15
		47	17	13
		nën.47	nën.17	0
3	Tërheqje në hekur	16	8	25
		15	7	23
		14	6	20
		13	5	18
		12	4	15
		11	3	13
		nën.11	nën.03	0
4	Vrapim rezistence 3000 m me uniformë sportive.	13’	16’	25
		13’ 15’’	17’	23
		13’ 30’’	17’30	20
		13’ 50’’	18’	17
		14’	18’ 30’’	15
		14’ 30’’	19’	13
		mbi 14’ 30’’	mbi 19’	0

FORMULAR VETËDEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit

Mbiemri, Emri	
Atësia/ Amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (një kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: ☐ i/e padënuar ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

(emër, mbiemër, firmë)

(emër, mbiemër, firmë, vulë)

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe

autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga

_____.

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

Shënim: Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe më pas sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.